



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 22 janar 2019  
Nr. ref.:RK 1316/19

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI92/18**

Parashtrues

**Abaz Gashi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Pzd. nr. 47/2018] të  
Gjykatës Supreme të Kosovës, të 30 prillit 2018**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Abaz Gashi, nga Klina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati Fisnik Mërlaku.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [Pzd. nr. 47/2018] e Gjykatës Supreme të Kosovës, të 30 prillit 2018.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, më të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 10 korrik 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 7 shtator 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme të Kosovës.
8. Më 11 dhjetor 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

9. Më 18 shtator 2015, Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti për të miturit (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), përmes Aktgjykimit P. nr. 212/12, e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale “*trafikim me njerëz*” nga neni 139, paragrafi 2, lidhur me nenin 1 të Kodit Penal të Kosovës, dhe e dënoi me 3 vjet burgim.
10. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, duke pretenduar se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është nxjerrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin.

11. Më 30 dhjetor 2015, Prokurori i Apelit përmes parashtresës PPAM/I. nr. 98/2015, kishte propozuar që ankesa e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar.
12. Më 24 mars 2016, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit PAKR. nr. 624/2016, aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës përkitazi me vendimin mbi dënimin dhe e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
13. Gjykata e Apelit e uli dënimin me burg parashtruesit të kërkesës nga 3 ( tri) vjet në dënim me burgim në 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj. Sa i përket pretendimeve tjera të parashtruesit të kërkesës, Gjykata i refuzoi si të pabazuara me arsyetimin se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte i qartë dhe konkret, duke u mbështetur në fakte dhe prova të administruara në mënyrë të drejtë.
14. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
15. Më 30 nëntor 2016, Gjykata Supreme e Kosovës, përmes Aktgjykimit PML. nr. 165/2016, refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

#### **Procedura lidhur me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit**

16. Në një datë të paspecifikuar, mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës paraqiti kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit në Gjykatën Supreme të Kosovës, me propozim që parashtruesit t'i shqiptohet një dënim më i butë, duke theksuar ndër të tjera, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike në të cilën janë familja e tij dhe arsyeve të tjera personale.
17. Më 21 nëntor 2017, Prokuroria Themelore në Pejë, me parashtresën PP. nr. 329/2010, kërkoi që kërkesa e parashtruesit për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të refuzohet.
18. Më 27 nëntor 2017, Gjykata Themelore në Pejë, përmes shkresës PK. nr. 477/2017, kishte kërkuar që të refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit.
19. Më 28 dhjetor 2017, Prokurori i Shtetit me parashtresën KZJD. nr. 169/2017 kërkoi të refuzohet kërkesa e parashtruesit për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit.
20. Më 15 janar 2018, Gjykata Supreme e Kosovës, përmes Aktvendimit Pzd. nr. 168/2017, kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, duke arsyetuar se *“nga shkresat e lëndës del se gjykata me rastin e vendosjes lidhur për llojin dhe lartësinë e dënimit ka vlerësuar rrethanat të cilat kanë ekzistuar në kohën e marrjes së vendimit. Rrethanat e reja të paraqitura në kërkesë nuk e kanë intensitetin e tillë që të ndikojnë në zbutjen e dënimit e as që mund të karakterizohen si rrethana që e arsyetojnë shqiptimin e dënimit më të butë”*.

21. Më 19 mars 2018, mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës paraqiti sërish kërkesë (të dytë) për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit në Gjykatën Supreme të Kosovës, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar dhe parashtruesit t'i shqiptohet një dënim më i butë, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike në të cilën janë familja e tij dhe, duke pretenduar se së fundmi parashtruesit të kërkesës i ishte keqësuar gjendja shëndetësore.
22. Më 30 prill 2018, Gjykata Supreme e Kosovës, përmes Aktvendimit (Pzd. nr. 47/2018), refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, duke arsyetuar se *“rrethanat në të cilat thirret mbrojtësi i tij në kërkesë nuk kanë peshë dhe ndikim në zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, ngase ato janë marrë parasysht gjatë marrjes së vendimit mbi dënim nga ana e gjykatës së shkallës së parë”*.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktvendimin e kontestuar, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
24. Parashtruesi i kërkesës së pari pretendon se vendimi i kontestuar është *“jo i drejtë, i pabazuar, i paargumentuar, i paarsyetuar dhe jo i logjikshëm për faktin se kjo gjykatë nuk ndërmori masat e duhura, zgjidhjen e kërkuar lidhur me rastin konkret [...]”*.
25. Më tej, parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Supreme e Kosovës *“i ka pasur të gjitha mundësitë ligjore për të bërë zbutjen e dënimit”*, dhe se nuk i ka marrë për bazë rrethanat e reja të cilat sipas parashtruesit të kërkesës kanë ndodhur pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 624/2016, të 24 marsit 2016.
26. Në thelb, parashtruesi ankohet se Gjykata Supreme nuk i ka marrë për bazë rrethanat lehtësuese për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, të cilat ai pretendon se *“janë të parapara me dispozita ligjore nga neni 74, paragrafi 3, rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale [...]”*.
27. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata:

*“... që të shpallë të pavlefshëm Vendimin e Gjykatës Supreme, Pzd. 47/2018, të datës 30.04.2018, i cili shkel nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së”*.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

28. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët parashikojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

*[...]*

30. Gjykata, gjithashtu, vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet së pari neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.*

31. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; ka shterur mjetet juridike në dispozicion; ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston në Gjykatë dhe ka dorëzuar kërkesën në kohë.
32. Megjithatë, Gjykata shqyrton gjithashtu nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës, që përcakton:

*“(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse*



ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(b) kërkesa nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën;  
[...].”

33. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. 47/2018, të 30 prillit 2018, me të cilin pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.
34. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në esencë bazon pretendimet e tij në vlerësimin e gabuar të provave të reja dhe në interpretimin e gabuar të normave ligjore gjatë vendosjes së Gjykatës Supreme lidhur me zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, me çfarë sipas parashtruesit, është shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] i KEDNJ-së.
35. Së pari, Gjykata përsërit se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.
36. Gjykata rikujton se në pajtim me praktikën shumëvjeçare dhe konstante të praktikës gjyqësore, neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së zbatohen gjatë gjithë procedurës në të cilën vendoset për “akuzat për vepër penale”, duke përfshirë edhe procedurën e shqiptimit të dënimit: (shih, *Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, nr. 41087/98, të 5 korrikut 2001, paragrafi 39.).
37. Gjithashtu, neni 6 i KEDNJ-së dhe neni 31 i Kushtetutës nuk janë të zbatueshëm në procedurat lidhur me ekzekutimin e vendimeve për dënim, siç është procedura për zbatimin e faljes (*Montcornet de Caumont kundër Francës*, Vendimi i GJEDNJ-së nr. 59290/00, i 13 majit 2003), procedura e faljes (*Aldrian kundër Austrisë*, Vendimi i Komisionit nr. 16266/90, i 7 majit 1990, shih gjithashtu, *Macedo da Costa kundër Luksemburgut*, Vendimi i GJEDNJ-së nr. 26619/07, i 5 qershorit 2012).
38. Mjetet juridike të jashtëzakonshme me të cilat kërkohet zbutje e jashtëzakonshme e dënimit, zakonisht nuk implikojnë vërtetimin e "të drejtave dhe obligimeve civile" apo bazueshmërinë e "çfarëdo akuze penale", dhe rrjedhimisht neni 6 nuk zbatohet për ta (shih, *inter alia*, *X kundër Austrisë*, numër 7761/77, Vendimi i Komisionit i 8 majit 1978, D.R. 14, f. 171, *Zawadzki kundër Polonisë* (vendimi) nr. 34158/96 i 6 korrikut 1999, *Hurter kundër Zvicrës* (vendimi), nr. 4811/07 i 15 majit 2012, *Dybeku kundër Shqipërisë* (vendimi) nr. 557/12, paragrafi 30, i 11 marsit 2014).
39. Prandaj, Gjykata konsideron se neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës nuk zbatohet për kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit gjatë

vlerësimin të kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme [Pzd. 47/2018, të 30 prillit 2018].

40. Gjykata thekson se pajtueshmëria *ratione materiae* e kërkesës me Kushtetutë, rrjedh nga kompetenca materiale e Gjykatës. E drejta në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës duhet të jetë e mbrojtur me Kushtetutë në mënyrë që ankesa kushtetuese të jetë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën. Megjithatë, Kushtetuta nuk i garanton parashtruesit të kërkesës të drejtën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit. (Shih: rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI80/15, KI81/15, KI82/15, *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, të 27 dhjetorit 2016, paragrafët 31-34).
41. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se ankesat e parashtruesit të kërkesës lidhur me refuzimin e gjykatave të rregullta për ta rihapur procedurën penale, për ta përsëritur vlerësimin e provave dhe për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, si të tilla nuk janë *ratione materiae* me Kushtetutën.
42. Rrjedhimisht, Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
43. Prandaj, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, *ratione materiae*.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës, më 11 dhjetor 2018, njëzëri

## VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim ne Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**



Radomir Laban



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Arta Rama-Hajrizi